

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë/ Gjuhë shqipe dhe letërsi		
Titulli i lëndës:	Shqipja letrare e shek. 16 – 18		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti i III –të; semestri i V -të		
Numri i orëve në javë:	2+0		
Vlera në kredi – ECTS:	4		
Koha / lokacioni:	13:30		
Mësimdhënësi i lëndës:	Ma. Diellza Hoxha; PhD		
Detajet kontaktuese:			
Përshkrimi i lëndës			
	Kursi synon t’ua ofrojë mundësinë studentëve të marrin informacione për të pasur më të lehtë leximin e atyre teksteve. Këto tekste janë botuar tashmë me aparaturë të nevojshme – transkriptim e shënime kritike.. Tekstet e vjetra të autorëve të shekujve 16 – 18 kanë një vlerë të rëndësishme gjuhësore në radhë të parë.		
Qëllimet e lëndës:			
	Përvetësimi i lëndës dhe aftësimi i studentëve për të bërë vështrime mbi Shqipen letrare të shek. XVI-XVIII.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	Në përfundimin e këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje: - të mund të njihet me bazat e alfabeve të shfrytëzuara nga autorët e vjetër të shek 16 – 18. - të ketë informacion për tekstet e vjetra të shqipes; - të dijë të gjejë materiale të duhura për tekstet e vjetra të shqipes; - të bëjë një analizë të lehtë gjuhësore të teksteve të vjetra;		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënimit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2 (90 min)	15	22,5
Ushtrime teorike/laboratorike			

Punë praktike	(min)		
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2,5
Ushtrime në teren	3	2	6
Kollokfiume,seminare	10	1	10
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	20	40
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet,prezentimet ,etj	30 min	1	0,5
Totali			146 orë 146:25 = 4,64 4 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia për realizimin e temave mësimore do të jetë bashkëkohore, interaktive bashkëbiseduese		
Metodat e vlerësimit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesëmarrja & aktiviteti 2. Pjesa e parë e provimit 3. Pjesa e dytë e provimit 4. Provimi me gojë 		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Rexhep Ismajli, Tekste të vjetra - Rexhep Ismajli, Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbërit (1706), E. Çabejt, Studime gjuhësore 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Kolë Ashta, Leksiku historik i shqipes - Mahmud Hysa, Krestomaci e letërsisë së vjetër shqiptare - Selman Riza, Fillimet e gjuhësisë shqiptare - Selman Riza, Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shq 		
Plani i dizajnuar i mësimit:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Objekti i lëndës. Burimet dhe metodat e studimit të saj. Koncepti për gjuhën letrare. Periodizimi i gjuhës shqipe. Mendimet e E. Çabejt, A. Desnickajas, S. Rizës e Sh. Demirajt. Periodizimi mbi kritere historike dhe gjuhësore.		

Java e dytë:	2- Familja e gjuhëve i.-e. Tiparet e përbashkëta të këtyre gjuhëve. Gjuhët e veçanta dhe grupet e gjuhëve të kësaj familjeje. Si duhet të kuptohet karakteri i.-e. i gjuhës shqipe. Mendimi i F. Boppit. Vendi i shqipes në rrethin e familjes i.-e. Teza e A. Shlajherit, Shmidit etj.
Java e tretë:	3- Prejardhja e gjuhës shqipe. Gjendja e dokumentacionit. Gjendja etnike e Gadishullit Ballkanik. Teoritë e ndryshme për këtë çështje.
Java e katërt:	4- Teza ilire e prejardhjes së gjuhës shqipe. Argumentet historike, arkeologjike e gjuhësore. Teza trake e prejardhjes së gjuhës shqipe. Argumentet dhe kundërgargumentet. Përfaqësuesit e kësaj teze.
Java e pestë:	5- Problemi i autoktonisë së shqiptarëve. Ç'kuptohet me termin autoktoni. Tezat e N. Joklit, Shtadtmylerit, E. Çabejt.
Java e gjashtë:	6- Rruga e formimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe dhe pikëpamjet që kanë ekzistuar në të kaluarën për këtë problem.
Java e shtatë:	7- Periodizimi i historisë së gjuhës letrare. A) Periudha e gjuhës letrare shqipe para rilindjes kombëtare, B) Periudha e gjuhës letrare shqipe në epokën e rilindjes dhe pas saj, C) Etapa e dytë e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe pas rilindjes (1912-1944), D) Etapa e tretë e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe.
Java e tetë:	Pjesa e parë e provimit
Java e nëntë:	8- Baza dialektore e sistemit të shqipes së sotme letrare.
Java e dhjetë:	Vecoritë kryesore në strukturën fonetike të shqipes së sotme letrare, A) Veçoritë kryesore të fushës e vokalizmit, B) Veçoritë kryesore në strukturën gramatikore të shqipes së sotme letrare, C) Veçoritë kryesore në strukturën fjalëformuese të shqipes së sotme letrare, D) Veçoritë kryesore në strukturën leksikore të shqipes së sotme letrare, E) Veçoritë kryesore funksionale të shqipes së sotme letrare.
Java e njëmbëdhjetë:	Marrëdhëniet e shqipes me greqishten. Disa bashkëpërkime të shqipes me greqishten e në kuadrin i.-e. Rrethanat historike të këtyre kontakteve. Kriteret gjuhësore që na shërbejnë për t'i dalluar ato. Fushat e ndikimit.
Java e dymbëdhjetë:	Marrëdhëniet e shqipes me latinishten. Latinishtja klasike

	dhe vulgare. Kushtet historike në të cilat lindën dhe u zhvilluan këto marrëdhënie. Fusha e ndikimeve të huazimeve latine dhe karakteristikat e tyre në gjuhën shqipe. veriut
Java e trembëdhjetë:	Marrëdhëniet e shqipes me sllavishten. Rrethanat, studimet rreth këtyre marrëdhënieve, Teza e Selishçevit, ndikimet sllave në toponimi, fjalëformim, ndikimet në fjalëformim etj. Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten. Rrethanat në të cilat janë krijuar këto marrëdhënie. Tri tezat për këtë problem. Bashkëpërkime të shqipes e të rumanishtes në elementin autokton dhe në atë latin.
Java e katërbëdhjetë:	Marrëdhëniet e shqipes me turqishten. Historia e këtyre marrëdhënieve. Fushat e ndikimit turk. Zëvendësimi i fjalës turke me atë shqipe.
Java e pesëmbëdhjetë:	Bashkëpërkime në gjuhët e Ballkanit. Studimet rreth këtyre bashkëpërkimeve. Tiparet gjuhësore ballkanike.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p><i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UP-së.</i></p> <p><i>Studenti duhet të vijoje me rregull ligjëratat</i></p> <p><i>Student duhet të ketë index ditën e provimit</i></p>	